



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**SH.A. PRODHIM KABLO SHKODER**

Nr. 24 Prot

Shkoder me: 30 / 03 / 2016

**Lenda:** Dergohet bilanci i mbylljes se Sh.A.Prodhim Kablo Shkoder per vitin 2015.

**DREJTORISE RAJONALE TE TATIMEVE**

**SHKODER**

Bashkangjitur ju dergojme bilancin e mbylljes se aktivitetit financiare te Sh.A.Prodhim Kablo Shkoder per vitin 2015 se bashku me informacionin perkates, raportit e auditimit te eksperteve kontabel te autorizuar dhe shenimet sqaruese ne forme elektronike.

**Faleminderit**



**Drejtori:**

Vitor Hila



*Handwritten signature*

"NDERMARRJA PRODHIM KABLLO"SH.A

# PASQYRAT FINANCIARE

(Mbështetur në Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", të ndryshuar, dhe në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Permiuesuara – SKK 2)

## Të dhëna identifikuese

- Emri "NDERMARRJA PRODHIM KABLLO SHKODER " Sh.a.
- NIPT J 66902025 D
- Adresa Zona Industriale Shkoder
- Data e krijimit 18.05.1965
- Nr Regj Tregt 3400011
- Fusha e veprimtarisë Konkension

## Të dhëna të tjera

- Pasqyra financiare  Individuale  
 Të konsoliduara
- Monedha LEK
- Rrumbullakimi \_\_\_\_\_
- Periudha Kontabël  
Nga 01.01.2015 Deri 31.12.2015
- Data e plotësimit të PF 23.03.2016
- Drejtori Vitor Hila



*Jr*

NDERMARRJA PRODHIM K A BILLOTRIA

❖ PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)

Nr. Ref.	AKTIVET	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
A-A	<b>Aktive Afatshkurtra</b>	<b>1,193,931,362</b>	<b>1,196,958,272</b>
A-A,1	Mjetet Monetare	68,443	3,352,456
A-A,2	<b>Investime:</b>		
1	Ne tituj pron. te njesive ekonomike brenda grupit	-	-
2	Aksionet e Veta	-	-
3	Te tjera financiare	-	-
	<b>Totali</b>		
A-A,3	<b>Te drejta te arketueshme</b>	<b>1,193,862,919</b>	<b>1,193,605,816</b>
1	Nga aktiviteti i shfrytezimit	181,990,903	181,990,903
2	Nga njesite ekonomike brenda Grupit	7,242,496	6,988,393
3	Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrje	-	-
4	Te tjera	1,004,629,520	1,004,626,520
5	Kapitali aksionar i papaguar	-	-
	<b>Totali</b>	<b>1,193,862,919</b>	<b>1,193,605,816</b>
A-A,4	<b>Inventari</b>		
1	Lendet e para & Materiale te konsumueshme	-	-
2	Prodhimi ne proces & Gjysem Produkte	-	-
3	Produkte te gatshme	-	-
4	Mallra per rishitje	-	-
5	Aktive Biologjike	-	-
6	AAGJ te mbajtura per shitje	-	-
7	Parapagime per inventare	-	-
	<b>Totali</b>		
A-A,5	Shpenzime te Shtyra	-	-
A-A,6	Te arketueshme nga te ardhurat e Konstatuara	-	-
	<b>Total i Aktiveve Afatshkurtra</b>	<b>1,193,931,362</b>	<b>1,196,958,272</b>
A-B	<b>Aktive Afatgjata</b>	<b>286,009</b>	<b>289,652</b>
A-B,1	<b>Aktive Financiare</b>		
1	Tituj pronesie ne njesite ekonomike brenda grupit	-	-
2	Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit	-	-
3	Tituj pron. ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrrese	-	-
4	Tituj Huadhe. ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrrese	-	-
5	Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjata	-	-
6	Tituj te tjere te huadhenies	-	-
	<b>Totali</b>		
A-B,2	<b>Aktive Afatgjata Materiale</b>	<b>286,009</b>	<b>289,652</b>
1	Toka dhe Ndertesa	-	-
2	Impiate & Makineri	10,931	14,574
3	Te tjera Instalime e Paisje	275,078	275,078
4	Parapagime per aktive materiale dhe ne proces	-	-
	<b>Totali</b>	<b>286,009</b>	<b>289,652</b>
A-B,3	Aktive Biologjike	-	-
A-B,4	<b>Aktive Afatgjata Jomateriale</b>		
1	Koncesione, Patenta, Licensa, Marka Tregtare	-	-
2	Emri i mire	-	-
3	Parapagime per AAJM	-	-
	<b>Totali</b>		
A-B,5	Aktive Tatimore te Shtyra	-	-
A-B,6	Kapitali i Nenshkruar i papaguar	-	-
	<b>Total i Aktiveve Afatgjata</b>	<b>286,009</b>	<b>289,652</b>

❖ PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)

13



**NDERMARRJA PRODHIM KABELLO'SH A**

Nr. Ref.	DETYRIMET DHE KAPITALI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
<b>D-A,1</b>	<b>Detyrimet Afatshkurta</b>	<b>8,383,775</b>	<b>9,101,773</b>
1	Titujt e huamarrjes		
2	Detyrime ndaj institucioneve te kredise		
3	Arketime ne avance per porosi		
4	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	3,619,146	3,440,842
5	Deftesa te pagueshme		
6	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		
7	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike me pjesemarrje		
8	Te pagueshme Sigurimet dhe Punonjesit	1,113,979	2,137,998
9	Te pagueshme per detyrimet tatimore	147,120	19,403
10	Te tjera	1,889,520	1,889,520
	<b>Totali</b>	<b>6,769,765</b>	<b>7,487,763</b>
D-A,2	Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
D-A,3	Te ardhura te shtyra	1,000,000	1,000,000
D-A,4	Provizione	614,010	614,010
	<b>Detyrime Totale Afatshkurtra</b>	<b>8,383,775</b>	<b>9,101,773</b>
<b>D-B,1</b>	<b>Detyrime Afatgjate</b>	<b>10,000,000</b>	<b>10,000,000</b>
1	Titujt te huamarrjes		
2	Detyrime ndaj institucioneve te kredise		
3	Arketimet ne avance per porosi		
4	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit Hua (A P Durres)	10,000,000	10,000,000
5	Deftesa te pagueshme		
6	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit		
7	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike me pjesemarrje		
8	Te tjera te Pagueshme	30,907,113	30,907,113
	<b>Totali</b>	<b>40,907,113</b>	<b>40,907,113</b>
D-B,2	Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		
D-B,3	Te Ardhura te shtyra	4,081,825	4,081,825
D-B,4	Provizione:	150,272,292	150,272,292
i	Provizione per pensionet		
ii	Provizione te tjera	150,272,292	150,272,292
D-B,5	Detyrime tatimore te shtyra		
	<b>Detyrime Totale Afatgjate</b>	<b>195,261,230</b>	<b>195,261,230</b>
	<b>Detyrime Totale</b>	<b>203,645,005</b>	<b>204,369,003</b>
<b>K-A,1</b>	<b>Kapitali i nenshkuar</b>	<b>938,200,000</b>	<b>938,200,000</b>
K-A,2	Primi i lidhur me kapitalin	102,743,993	102,743,993
K-A,3	Rezerva rivleresimi	650,516	650,516
K-A,4	Rezerva te tjera	5,690,279	5,690,279
i	Rezerva statutore		
ii	Rezerva ligjore	433,490	433,490
iii	Rezerva te tjera	5,256,789	5,256,789
K-A,5	Fitimi i pashperndare	(54,396,867)	(54,135,572)
K-A,6	Fitimi (humbje) e vitit financiar	(2,315,555)	(261,295)
	<b>Totali i Kapitalit</b>	<b>990,572,366</b>	<b>992,887,921</b>

**❖ PASQYRA E PERFORMANCES**  
**(PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE)**

*[Handwritten signature]*



**DEKLARATA PER SHUMEN E ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE**

Nr. Ref.	TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>96,510</b>	<b>2,121,625</b>
P-P,1	Te Ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit	96,510	2,121,625
P-P,2	Ndryshimet ne inventarin e produkteve	-	-
P-P,3	Puna e Kryer nga njesia ekonomike dhe	-	-
P-P,4	Te ardhura te tjera te shfrytezimit	-	-
<b>1</b>	<b>TOTALI TE ARDHURAVE (Shuma P-P,1-P-P,4)</b>	<b>96,510</b>	<b>2,121,625</b>
	<b>TE SHPENZIMEVE</b>	<b>(2,400,465)</b>	<b>(2,389,081)</b>
P-P,5	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	-	-
1	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	-	-
2	Mallra	-	-
3	Te tjera shpenzime	-	-
P-P,6	Shpenzime te personelit	(1,091,670)	(1,820,490)
1	Pagat & Shperblimet	(935,450)	(1,559,977)
2	-shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	(156,220)	(260,513)
3	-shpenzime per honorare	-	-
P-P,7	Zhvleresimi i AAGJ	-	-
P-P,8	Shpenzime Konsumi & Amortizimi	(3,643)	(4,857)
P-P,9	Shpenzime te tjera shfrytezimi	(1,305,152)	(563,734)
<b>2</b>	<b>TOTALI SHPENZIMEVE (Shuma P-P,5-P-P,9)</b>	<b>(2,400,465)</b>	<b>(2,389,081)</b>
	<b>TE ARDHURAVE SHPENZIMESH FINANCIARE</b>	<b>(11,600)</b>	<b>6,161</b>
P-P.10	Te ardhura te tjera	(11,600)	6,161
1	Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka	-	-
2	Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka	-	-
3	Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera pjese e aktiveve	-	-
4	Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera pjese e aktiveve	-	-
5	Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme	(11,600)	6,161
6	Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme,	-	-
P-P.11	Zhvleresimi i aktiveve financiare dhe	-	-
P-P.12	Shpenzime Financiare	-	-
1	Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme	-	-
2	Shpenzime interesi dhe shpenzime te	-	-
P-P.13	Pjesa e fitimit/Humbjes nga pjesemarrjet	-	-
<b>13</b>	<b>TE ARDHURA/SHPENZIME FINANCIARE</b>	<b>(11,600)</b>	<b>6,161</b>
	<b>TE ARDHURAVE SHPENZIMESH NETO</b>	<b>(11,600)</b>	<b>(61,720)</b>
P-P.15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	-	-
1	Shpenzimi aktual i tatim fitimit	-	-
2	Shpenzimi i tatim fitimit te shtyre	-	-
3	Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjes	-	-
P-P,16	<b>FITIMI/HUMBIA NETO E VITIT FINANCIAR</b>	<b>(2,315,555)</b>	<b>(261,295)</b>
P-P,17	<b>FITIM/HUMBIA PER:</b>		
1	Per pronaret e njesise ekonomike meme	-	-
2	Interesat jo kontrolluese	-	-



INDEKSMARRJA PRODHIM KABELLO'SH.A

❖ PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE

Nr. Ref.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
<b>TE ARDHURAT GJITHEPERFSHIRESE</b>			
P.AGJ.1	Fitim Humbja e Vitit	(2,315,555)	(261,295)
P.AGJ.2	Te Ardhurat Gjitheperfs hirese per vitin		
1	Diferencat (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja		
2	Diferencat (+/-) nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
3	Diferencat (+/-) nga rivleresimi i aktiveve financiare te mbajtura per shitje		
4	Pjesa e te ardhurave gjitheperfs hirese nga pjesemarrjet		
5	Totali i te ardhurave te tjera gjitheperfs hirese per vitin		
	Totali i te ardhurave gjitheperfs hirese per vitin	(2,315,555)	(261,295)
P-P.17	Totali i te ardhurave gjitheperfs hirese per:	(2,315,555)	(261,295)
1	Pronaret e njesise ekonomike meme		
2	Interesat jo-kontrolluese		

❖ PASQYRA E FLUKSIT MONETAR



UNDERMARRJA E PRODHIM KABILLO'SH A

Nr. Ref.	FLUKSI MONETAR	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
1	<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(perdorur ne) aktivitetin e shfrytezimit</b>	<b>(3,284,013)</b>	<b>1,923,260</b>
i	Te arketuara nga te drejtat e arketueshme	96,510	2,121,625
ii	Te paguara per detyrimet e pagueshme dhe	(3,380,523)	(198,365)
iii	Pagesa te Tjera	-	-
1-A	<b>Mjete Monetare te gjeneruara nga aktiviteti i shfrytezimit</b>	<b>(3,284,013)</b>	<b>1,923,260</b>
i	Interesi i paguar	-	-
ii	Tatim mbi fitimin i paguar	-	-
	<b>Mjete Monetare nga/(perdorur ne) aktivitetin e shfrytezimit</b>	<b>(3,284,013)</b>	<b>1,923,260</b>
2	<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(perdorur ne) aktivitetin e investimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
i	Para neto te perdorura per blerjen e filialeve	-	-
ii	Para neto te arketuara nga shitja e filialeve	-	-
iii	Pagesa per blerje AAGj	-	-
iv	Arketime nga shitja e AAGj	-	-
v	Pagesa per blerjen e investimeve te tjera	-	-
vi	Arketime nga shitja e investimeve te tjera	-	-
vii	Dividente te arketuar	-	-
	<b>Mjete Monetare nga/(perdorur ne) aktivitetin Investues</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
3	<b>Fluksi i mjeteve monetare nga/(perdorur ne) ne aktivitetin e financimit</b>	<b>-</b>	<b>1,344,851</b>
i	Arketime nga emetimi i kapitalit aksionar	-	-
ii	Arketime nga emetimi i aksioneve te perdorura	-	-
iii	Hua te arketuara	-	-
iv	Pagesa e kostove te transakcionit qe lidhen me	-	-
v	Riblerja e aksioneve te veta	-	-
vi	Pagesa e aksioneve te perdorura si kolateral	-	-
vii	Pagesa e Huase	-	-
viii	Pagesa e detyrimeve te qirase financiare	-	-
ix	Interesi i arketuar	-	-
x	Dividente te paguar	-	1,344,851
	<b>Mjete Monetare nga/(perdorur ne) aktivitetin e financimit</b>	<b>-</b>	<b>1,344,851</b>
4	<b>Fluksi i mjeteve monetare nga/(perdorur ne) aktivitetin e mjeteve monetare</b>	<b>(3,284,013)</b>	<b>3,268,111</b>
5	<b>Mjete monetare dhe ekuivalente</b>	<b>3,352,456</b>	<b>84,346</b>
6	<b>Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare me afatgjatë</b>	<b>68,443</b>	<b>3,352,456</b>
7	<b>Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare me afatgjatë</b>	<b>68,443</b>	<b>3,352,456</b>

**"NDERMARRJA PRODHIM KABLO"SH.A**

**❖ PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO**

LEVIZJA E KAPITALEVE	KAPITALI AKSIONAR	PRIMI I LIDHUR ME AKSIONIN	REZERVA	FITIMI I PA SHPERNDARE	FITIMI I VITIT FINANCIAR	TOTALI
<b>Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2013</b>	938,200,000	102,743,993	6,340,795	(51,861,828)	(2,273,744)	993,149,216
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar me 1 Janar 2014</b>						
<b>Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin:</b>						
Fitim/Humbja e vitit					(261,295)	(261,295)
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse						
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin						
Transaksionet me pronarët të njohura në kap.				(2,273,744)	2,273,744	
Emetimi i kapitalit të nenshkruar						
Dividendët e paguar						
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njesise ekonomike</b>						
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar me 31 Dhjetor 2014</b>	938,200,000	102,743,993	6,340,795	(54,135,572)	(261,295)	992,887,921
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar me 1 Janar 2015</b>	938,200,000	102,743,993	6,340,795	(54,135,572)	(261,295)	992,887,921
<b>Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin:</b>						
Fitim/Humbja e vitit					(2,315,555)	(2,315,555)
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse						
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin						
Transaksionet me pronarët të njohura në kap.				(261,295)	261,295	
Emetimi i kapitalit të nenshkruar						
Dividendët e paguar						
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njesise ekonomike</b>				(261,295)	(2,054,260)	(2,315,555)
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar me 31 Dhjetor 2015</b>	938,200,000	102,743,993	6,340,795	(54,396,867)	(2,315,555)	990,572,356

DREJTORI

SIOR HIL

*[Signature]*



K. d. financës

*[Signature]*

*[Signature]*



## INFORMACION

### Mbi mbylljen e aktivitetit financiare te Sh.a Prodhim Kablo Shkoder per vitin 2015.

Aktiviteti financiare i Sh.A. Prodhim Kablo Shkoder per vitin 2015 eshte mbyllur me humbje -2.315.555 leke. Ne vitin 2015 sh.a-ja ka realizuar te ardhura si me poshte vijon:

1. Nga vlersimi i nje sasie skrapit nga eksperti i vlersimit te makinerive Z. Defrim Voda ne vitin 2015, sasi e cila eshte bere dalje nga sh.a-ja ne vitin 2014, tek firma "NIKA" shpk me faturim pjesor te sasise. Kjo per vete natyren e skrapit pasi ky skrap perbehej nga tre depo (bote) mazuti te cilat mbrenda tyre kishin mbeturina mazuti e skorje te ndryshme, dhe pesha e tyre nuk percaktohej e sakte me peshore.  
Pasi u be vlersimi i ketyre tre depove (bote)doli se firma "NIKA" shpk i detyrohej sh.a-se edhe 96.510 leke. Me daten 31.12.2015 firma "NIKA" shpk eshte debitore prane nesh per shumen 230.460 leke duke perfshire edhe detyrimin e krijuar me daten 31.12.2014 per vleren 133.950 leke si rezultat i sasise se skrapit te blere prane sh.a-se dhe te palikujduar. Megjithe komunikimet tona zyrtare dhe gojore firma "NIKA" nuk eshte paraqitur per te bere likujdimin e ketij detyrimi debitor per shumen 230.460 leke.
2. Te ardhura dhe shpenzime nga interesi -11.600 leke.

Pra, sh.a-ja per vitin 2015 ka realizuar gjithsejt 84.910 leke te ardhura.

Shpenzimet e kryera ne sh.a per vitin 2015 jane per pagat e punes per sigurimet shoqerore e shendetsore, keshillin mbikqyres, ekspertet kontabel, eksperti i vlersimit te makinerive per skrap, udhetime e dieta, sherbim postare, kancelari, etj...

Persa i perket problemit te debi-kredive gjendja paraqitet me pak ndryshime, te cilat jane sqaruar tek "Shenimet sqaruse" te bilancit te dates 31.12.2015.

Faleminderit

Drejtori: Vitor Hila



Ja



# RAPORTI I EKSPERTEVE KONTABEL RREGJISTRUAR

## Periudha 1 Janar 2015 - 31 Dhjetor 2015

3/22/2016

"NDERMARRJA PRODHIM KABLLO SHKODER"Sh.a.

Fatbardha SHTREPI, Neshat MAZAJ , Eksperte Kontabel te Rregjistruar

10

I. RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

II. PASQYRAT FINANCIARE DERI NE 31.12.2015

- ❖ PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
- ❖ PASQYRA PERFORMANCES
- ❖ PASQYRA E TE ARDHURAVE GJTHEPERFSHIRESE
- ❖ PASQYRA E FLUKSIT MONETAR
- ❖ PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALIT
- ❖ PASQYRA E GJENDJES DHE NDRYSHIMEVE TE AAM

III. SHENIME PER DREJTIMIN E SHOQERISE

- 1) Te dhena te Pergjithshme mbi shoqerine
- 2) Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabel
- 3) Organizimi i Kontabilitetit
- 4) Shenime per Pasqyrat Financiare

---



## I. Raport i Eksperteve Kontabel te Rregjistruar Mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare te Shoqerise

### “NDERMARJA PRODHIM KABLLO SHKODER” Sh.a.

Drejtuar:

1. Aksionerit te Vetem
2. Keshillit Mbikqyres
3. Administratorit

Te Shoqerise “ NDERMARJA PRODHIM KABLLO SHKODER” Sh.a.

Adresa: Zona Industriale, Shkoder

Lidhur me shqyrtimin e Pasqyrave Financiare te periudhes Janar 2015 – Dhjetor 2015

Te nderuar Zoterinj !

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare bashkalidhur te shoqerise “ NDERMARRJA PRODHIM KABLLO SHKODER” Sh.a., per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2015, qe perfshijne Pasqyren e Pozicionit Financiar (Aktivet, Detyrimet dhe Kapitalin), Pasqyren e Performances, Pasqyren e Te ardhurave Gjitheperfishirese, Pasqyra e Flukseve Monetare dhe Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital per kete ushtrim, si dhe nje permbledhje te Politikave Kryesore Kontabel dhe Shenimet Shpjeguese.

#### Pergjegjesia e Drejtimit te Shoqerise

Drejtimi i Shoqerise eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te Pasqyrave Financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara (S.K.K. te Permiresuara) Kjo pergjegjesi perfshin : hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te Pasqyrave Financiare pa gabime materiale nga pasaktesia ose gabime, per zgjedhjen dhe aplikimin e politikave kontabel dhe berjen e vleresimeve te duhura kontabel te pershtatshme per shoqerine.

#### Pergjegjesia Audituesive te Pavarur

Pergjegjesia jone eshte qe, bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto Pasqyra Financiare. Ne e kryem auditimin ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit (S.N.A.) Keto Standarte kerkojne qe ne te permbushim kerkesat e etikes, dhe te planifikojme e kryejme auditimin per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale. Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per sigurimin e te dhenave te auditimit per shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura jane ne gjykim te audituesve, duke perfshire vlersimin e rrishtit te anomalive materiale si rezultat i gabimeve ose pasaktesive. Gjate vlersimit te ketyre rrezeqeve, audituesit merrin ne konsederate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te Pasqyrave Financiare ne menyre qe te percaktoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat financiare, por jo per qellim te shprehjes se nje opinionimi per efektivitetin e kontrollit te brendshem te shoqerise. Auditimi perfshin gjithashtu vlersimin e pershtatshmerise se



*Handwritten signature*



**EKSPERTI I KONTABEL TE REGJISTRUAR**

Fatbardha Shtrepi,  
Neshat Mazaj

parimeve kontabile te perdorura dhe pranueshmerine e cmuarjeve kontabile te kryera nga drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te Pasqyrave Financiare. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin pershtatshmerise se parimeve kontabel te perdorura dhe te arsyeshmerise se cmuarjeve te rendesishme kontabel te bera nga Drejtimi, si edhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te Pasqyrave Financiare.

Ne besojme se te dhenat e auditimit qe ne kemi siguruar jane te mjaftueshme dhe te pershtatshme per te bazuar opinionin tone.

**Opinion**

Sipas opinionit te Eksperteve Kontabel te Rregjistruar, Pasqyrat Financiare te Shoqerise "NDERMARRJA PRODHIM KABLLO SHKODER" Sh.a. Pasqyrat Financiare japin nje pamje te vertete dhe te besueshme te gjendjes financiare te Shoqerise, me date 31 Dhjetor 2015, si dhe te rezultateve te veprimtarive te saj per ushtrimin e mbyllur, ne pajtim me Standartet Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara (SKK.) dhe respektojne Ligjin nr 9228 date 29 04 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar..

Me respekt

Fatbardha SHTREPI

Neshat Mazaj

Ekspert Kontabel i Rregjistruar



Tirane, me 22 Mars 2016



Handwritten number 43



EKSPERTET KONTABEL TE REGJISTRUAR  
Fatbardha Shirepi,  
Neshat Mazaj

## SHENIME PER DREJTIMIN E SHOQERISE

Shoqeria: "NDERMARRJA PRODHIM KABLLO SHKODER " SH.A.

Periudha ushtrimore 01 Janar 2015 deri me 31 Dhjetor 2015

### 1) TE DHENA TE PERGJITHSHME TE SHOQERISE

Shoqeria **NDERMARRJA PRODHIM KABLLO SHKODER " SH.A.** , eshte krijuar me date 24.03.1999. Me Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr 21105, Shoqeria eshte rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar. Krijimi i kesaj shoqerie eshte bazuar ne ligjin Nr.7638 Dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", Shoqeria ne baze te ketij ligji Seksioni III, Neni 94,95 eshte shenderuar dhe funksionon si Shoqeri Anonime. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi si dhe nga Statuti i saj.

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne Shqiperi, me adrese: Zona Industriale, Shkoder

Ajo eshte regjistruar prane organeve Tatimore te rrethit Shkoder me NIPT J 66902025 D

Objekti i veprimtarise se Shoqerise "NDERMARRJA PRODHIM KABLLO SHKODER " SH.A. , konsiston ne "Prodhim dhe tregetim i telave elektrikete veshur dhe te zhveshur me alumin dhe baker, prodhim i kabllove te ndryshem, etje.

Veprimtaria e Shoqerise zhvillohet ne nje afat kohor te pa caktuar.

#### a) Kapitali dhe pronësia

Kapitali i Shoqerise ne momentin e krijimit te saj eshte 809 000 000 leke. Gjate gjithë periudhes qe nga krijimi i shoqerise se deri ne 31.12.2015 kapitali i shoqerise ka pesuar ndryshime duke zmadhuar. Te gjitha ndryshimet ne kapitalin e shoqerise jane bere ne zbatim te legjislacionit ne fuqi sipas periudhes kur kane ndodhur dhe jane rregjistruar ne Gjykatën e Shkalles se pare Tirane dhe ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit. Ne dt 31.12.2015 Kapitali aksionar i Shoqerise eshte 938 200 000 leke. Numri kontributeve ne aksione eshte 938 200, Vlera nominale e kontributit 1 000 leke. Aksioner i vetem i Shoqerise eshte Ministria e Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes, Perqindja e pjesmarjes 100%.

#### b) Administrimi

Struktura organike, Administrimi, Organizimi, Drejtimi i pershtaten natyres se Shoqerise dhe realizimit te objektit të veprimtarisë së saj. Perfaqesuesi Ligjor i Shoqerise ne 31.12.2015 eshte z Viktor Hila. Shoqeria drejtohet nga Administratori. Administrimi e ushtron funksionin e tij nen kontrollin e keshillit mbikqyres i cili organi Vendimmarres i Shoqerise.

Anetaret e keshillit mbikqyres ne dt.31.12.2015 jane:

- Gjergji KOSTA
- Enea KARAKACI
- Valentina LAME

Ndryshimet ne Administrimin e Shoqerise, ne perberjen e Keshillit Mbikqyres si dhe te gjitha vendimet e aksionetir te vetem te saj nuk jane pasqyruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit qe nga viti 2005.





## 2) MBI KONTABILITETIN

### A. Baza e përgatitjes

#### a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur ne përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara (SKK) te Publikuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit dhe interpretimeve. Standardet janë zbatuar deri në nivelin që ato janë përkthyer dhe adoptuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Shqipëri (KKK).

#### Baza e matjes

Pasqyrat-financiare janë përgatitur bazuar ne parimin e kostos historike, si dhë ne raportin e eksperteve te vleresimit dhe te eksperteve kontabel te autorizuar te vitit 2008

#### b) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur ne Leke, e cila është monedhe funksionale për shoqërinë.

#### c) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK, kërkon që drejtimi i shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojnë si pasojë e këtyre çmuarjeve.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përshkruhen në paragrafët me poshtë:

#### i. Humbje nga rënia e vlerës se aktiveve financiare

Shoqëria teston vlerën e aktiveve te saj financiare rregullisht per te konstatuar renie te mundshme vlere. Për te përcaktuar nëse një rënie e mundshme vlere duhet njohur ne pasqyrën e te ardhurave, Shoqëria gjykon nëse ka ndonjë te dhëne te dallueshme qe te ketë një rënie te matshme ne flukset monetare te pritshme nga portofoli i aktiveve financiare, përpara se ulja te identifikohet e ekspozuar individualisht ne portofol.

Kjo evidence mund te përfshije te dhëna te dallueshme qe tregojnë se ka pasur një ndryshim jo te favorshëm ne gjendjen e pagesave te klienteve ne Shoqëri, apo ne gjendjen ekonomike kombëtare apo lokale qe lidhet me mospagesat ne aktivet e Shoqërisë.

#### ii. Përcaktimi i vlerës se drejte

Përcaktimi i vlerës se drejte për aktivet financiare dhe detyrimet për te cilat nuk ka një çmim tregu te dallueshëm, kërkohet përdorimi i teknikave vlerësuese siç përshkruhet ne shënimin 4 ne pasqyrat financiare.

#### iii. Përlllogaritja e tatim fitimit

Drejtimi beson se përlllogaritja e tatimit mbi fitimin është i kujdesshem duke pasur parasysh ambientin fiskal shqiptar dhe legjislacionin ekzistues ne fuqi dhe rezultatet e mundshme te çdo inspektimi tatimor, nuk do te ketë ndikim sinjifikativ ne pozicionin financiar, rezultatit operative apo flukset monetare te Shoqërisë.



**d) Parimet e konsolidimit**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë nuk konsolidohen mbasi shoqëria nuk është pjesë e zbatimit të këtij parimi. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur të njëjtat parime të matjeve dhe njohjeve.

**Politikat kontabël të paraqitura me poshtë janë aplikuar qëndrueshëm në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.**

**B. Politikat kryesore Kontabël**

**a) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që-maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumenteve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka).

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
<b>Kurset e Këmbimit</b>	-	-
Euro/Leke	137.28	140.14
Usd/Leke	125.79	115.23
Chf/Leke	126.74	116.52
Gbp/Leke	186.59	179.48

**b) Instrumentet financiare**

Instrumente financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë llogari të arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to, dhe llogari të pagueshme. Gjate periudhave të raportimit shoqëria ka investime në letra me vlerë. Instrumentet financiarë jo-derivativë janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumenteve financiarë joderivativë përshkruhet më poshtë

Një instrument financiar njihet në rast se Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar perndujone, ose të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë regjistruar në datën e tregtimit, psh datën në të cilën Shoqëria zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

- *Mjete monetare dhe ekuivalente me to*





Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogarite rrjedhëse në banka. Për qëllime të fluksit të mjeteve monetare, këtu përfshihen edhe depozitat në formën e garancisë për huatë me maturitet me shume se 3 muaj ose me pak nga data origjinale.

o *Kërkesa për arkëtim*

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të pakësuara për humbjet për zhvlerësime.

o *Llogari të detyrime të pagueshme*

Llogaritë e detyrimeve të pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

o *Hua dhe kredi*

Në vijim të njohjes fillestare, huatë dhe kreditë paraqiten me kosto të amortizuar me ndonjë diferencë ndërmjet koston dhe vlerës së riblerjes që njihet në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në normën e interesit efektiv.

o *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

o *Te tjera*

Instrumenta financiarë të tjerë jo-derivativë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kontabiliteti për të ardhurat dhe shpenzimet financiare shpjegohet në shënimet e mëposhteme.

**c) Aktive afatgjata materiale**

*i. Njohja dhe matja*


Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, (nëse ka). Në vitin 2008 ato kanë qenë objekt rivlerësimi.

Toka dhe ndertesa përfshijnë pergjithesisht ambjentet e zyrave. E gjithë pasuria e paluajtshme, ndertesat dhe makinerite paraqiten në kosto, të rivlerësuar (sic përkrahjet në paragrafin e mëposhtëm) minus amortizimin përkatës dhe zhvlerësimin, përveç për token, e cila pasqyrohet me koston e rivlerësuar minus zhvlerësimin. Kosto e aktiveve të ndertuara vetë përfshijnë koston e materialeve, punës direkte, si dhe çdo kosto tjetër që lidhet me sjelljen e këtyre aktiveve në gjendje pune dhe koston për montimin dhe levizjen e tyre dhe përgatitjen e vendit në të cilin do të vendosen. Programet kompjuterike të blera që janë të nevojshme për vendosjen në funksion të këtyre aktiveve të cilat kapitalizohen si pjesë të këtyre makinerive.

Aktivitet të cilat janë nxjerre jashtë përdorimit kanë qenë të kontabilizuar me vlerën e bazuar në vlerën e tyre neto në datën e daljes jashtë përdorimit.

Koston e pjesëve të ndërrimit për makinerite dhe pajisjet njihen me vlerën e tyre kontabel nëse është e mundur që njesia ekonomike të përfitojë të ardhura ekonomike nga kjo pjesë dhe këto të ardhura mund të maten në mënyrë të besueshme. Koston e mirëmbajtjes dhe riparimeve të përditshme të pasurive të paluajtshme, makinerive dhe pajisjeve njihen në fitim e humbje kur ato ndodhin.

*ii. Amortizimi*



*Handwritten signature*



**EKSPERTI KONTABEL TE REGJISTRUAR**

Fatbardha Shirepi,  
Neshat Mazaj

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metoden lineare mbi vlerën e mbetur kontabel në mënyrë që, kosto e çdo aktivi deri në vlerën e mbetur, të shpërndahet përgjate të gjithë jetës së tij të dobishme si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
GRUPET A.A.M-ve	Jeta e dobishme e aam	Jeta e dobishme e aam
Ndertesat	20 vjet	20 vjet
Instalime teknike makineri e paisje	5 vjet	5 vjet
Mjete transporti	5 vjet	5 vjet
Paisje zyre	5 vjet	5 vjet
Paisje informatike	4 vjet	4 vjet

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur (nëse nuk është e pakonsiderueshme) të aktiveve materiale afatgjate janë rishikuar në datën e raportimit.

Toka dhe Ndertimet në Proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen nga krahasimi i perfitimeve me vlerën e tyre kontabel. Keto përfshihen në pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

**iii. Kostot e vijuese**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjate materiale njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuhen atij elementi do të rrjedhin Shoqërisë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjate materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin

**d) Aktivët e marra me qira**

Aktivët e marra me qira janë të klasifikuara si qira financiare kur termat e transferimit të risqeve dhe pronësisë kalojnë te qiramarrësi. Të gjitha qeratat e tjera janë të klasifikuara si qera operative.

Asetet që janë rregjistruar si qera financiare rregjistrohen si asete të Shoqërisë me vlerën e drejtë në datën e fillimit të qerasë, ose me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qerasë nëse kjo e fundit është më e vogël.

Pagesat e qerasë rregjistrohen si shpenzimeve financiare dhe zvogëlimit të detyrimit të qerasë që të arrijë një normë konstante të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimit.

**e) Inventarët**

Mallrat vlerësohen me vlerën më të vogël të koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përfshin materialet direkte dhe punën direkte kur është e aplikueshme dhe kostot e tjera që janë shpenzuar për të sjellë inventarët në gjendjen dhe vendin aktual. Vlera neto e realizuar tregon vlerën e çmuar të çmimit të shitjes në aktivitetin e biznesit, duke i zbritur koston e çmuar të marketingut, shitjes dhe shpërndarjes. Kostoja e inventarëve të tjerë është bazuar në parimin FIFO (e hyra e pare e dala e pare) dhe përfshin shpenzimet e përdorura në përvetësimin e inventarit dhe për të sjellë ato në kushtet dhe vendin e tyre ekzistues. Shuma e përshtatshme për zhvlerësim njihet në pasqyrën e të ardhurave kur ka një evidence objektive që aktivi është zhvlerësuar.

**f) Zhvlerësimi**

**i. Aktivët financiare**



Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidenca objektive zhvlerësimi tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të vlefshëm për shitje është llogaritur kundrejt vlerës së tij të drejte.

Aktivitetet financiare të cilat janë të konsiderueshme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet se bashku në grupe që mbartin karakteristika të ngjashme rrisht.

Te gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Ndonjë humbje kumulative në lidhje me aktivitetet financiare të vlefshme për shitje të njohura me pare në letra me vlerë transferohet tek humbje fitimi.

Një humbje nga zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anullimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

## ii. Aktivitetet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Humbjet nga zhvlerësimi në periudhat e mëparshme janë rishikuar në çdo datë raportimi për rastet kur humbja rritet ose nuk ekziston më. Një humbje zhvlerësimi anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për caktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

## g) Përfitimet e punonjësve

### i. Sigurime shoqërore të detyrueshme

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

### ii. Leje vjetore të paguara

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve për gjatë periudhës.

## h) Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si një rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve duke personifikuar fitime ekonomike do të jete e nevojshme për të rregulluar detyrimin dhe një vlerësim të besueshëm të vlerës së detyrimit që mund të behet. Nëse efekti është material, provizionet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohe të parasë, dhe kur është e nevojshme rrishtun specifik të detyrimit. Provizionet paraqiten në çdo datë bilanci dhe nëse nuk është akoma e mundur që rrjedhja e burimeve duke personifikuar burime ekonomike të përdoret për rregullimet e detyrimeve, provizionet anulohen. Provizionet përdoren



*Je*

vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje shfrytëzuese të ardhme. Aktivitet dhe detyrimet e rastit nuk njihen.

**i) Njohja e të ardhurave**

Te ardhurat maten me vlerën e drejte të shumës së marre ose për tu arkëtuar dhe përfaqëson vlerën e arketueshme për të mirat dhe shërbimet të siguruar gjatë aktivitetin normal të biznesit, neto nga zbritjet dhe shitjet të lidhura me taksën.

Shitjet e mallrave njihen kur mallrat janë dërguar dhe gjithashtu kanë kaluar dhe pronësinë e tyre. **E ardhura nga shërbimet e kryera njihet në pasqyrën e të ardhurave në përpjesëtim me volumin e shërbimit të kryer në datën e bilancit.** Volumi i shërbimit vlerësohet duke iu referuarurvejimeve të punës së kryer.

**j) Rimbursimet e kostos së marketingut dhe kostove të shitjes**

Rimbursimet për programet e marketingut për të promovuar shitjen e produkteve të licensuara janë të njohura si të ardhura të vitit në të cilin kanë ndodhur dhe shpenzimet përkatëse.

Rimbursimi i kostove të shitjes është njohur si e ardhur në të njëjtën kohë me shitjet e produkteve të cilave i referohet.

**k) Shpenzimet**

**i. Pagesat e qerave**

Pagesat e bëra për qerata operacionale njihen në fitim ose humbje me mënyrën lineare gjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së marre njihen si një pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë periudhës së qirasë.

Minimumi i pagesave të qerasë të bëra nën qerata financiare janë shpërndarë midis shpenzimeve financiare dhe pakësimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimi financiar është shpërndarë në çdo periudhë të termave të qerasë për të krijuar një normë interesi konstante periodike mbi tepricën e mbetur të detyrimit.

**ii. Te ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen dhe përlllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Të gjitha kostot e huave njihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**l) Tatim fitimi**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatim fitimi njihet si zë i kapitalit.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyre është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyre llogaritet në normën e tatimit që pritet të aplikohet në diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin tatimor që janë ose hyjnë në fuqi në datën e raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për atë që është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm



*Handwritten signature or initials.*



do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktiviteti tatimor i shtyrë zvogëlohet për atë sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

#### m) Përcaktimi i vlerës së drejte

Disa nga politikat kontabël dhe shenimet e pasqyrave financiare e Shoqërisë kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejte, për të detyrimet dhe aktivet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejte është përdorur për qëllime matjeje dhe zbulimi bazuar në metodat e mëposhtme. Kur është e aplikueshme, informacione të mëtejshme rreth supozimeve të bëra për vlerën e drejte është paraqitur në shënimin specifik të aktiveve dhe detyrimeve.

##### i. Kërkesa për arkëtim nga debitorët

Vlera e drejtë e kërkesave për arkëtim, klientëve dhe llogarive të tjera të arkëtueshme, është matur si vlera aktuale e flukseve të ardhshme, të skontuara me normën e interesit të tregut në datën e raportimit.

#### n) Menaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- o risku kredisë
- o risku i likuiditetit
- o risku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare. Menaxhimi mbart përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e politikave të Shoqërisë për menaxhimin e riskut.

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Bordi i Drejtoreve mbikëqyr, se si drejtuesit monitorojnë përputhshmëritë me politikat, procedurat e rishikimit e administrimit të riskut të Grupit dhe Shoqërisë, si dhe përshtatshmërinë e kuadrit të administrimit të riskut në lidhje me rreziqet e përballuara nga Shoqëria.

Instrumentet financiare kryesore të Shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në banka para, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme dhe detyrime të tjera afatshkurtra..

##### i. Ndryshimet e shpeshta në tregjet financiare globale dhe në Shqipëri

Kriza e vazhdueshme financiare dhe ekonomike ka ndikuar, midis të tjerash, në një financim me të pakët të tregjeve të kapitaleve, nivele likuiditeti me të ulëta në sektorin bankar, si dhe ndonjë here norma e interesit të borxhit ndërbankar me të larta dhe ndryshueshmëri të shpeshte tek tregjet e aksioneve. Paqartësitë në tregjet financiare globale kanë sjelle edhe falimentimin e bankave si dhe ndihmave të dhëna ndaj bankave të tjera përgjatë gjithë globit. Shtrirja e plote e ndikimit të krizës financiare në vazhdim është duke provuar që është e pamundur që të parashikohet ose të jesh i mbrojtur plotësisht kundrejt saj.

##### ii. Ndikimi në likuiditete

Volumi i shitjeve me shumicë është reduktuar në mënyrë të ndejshme së fundmi. Rrethana të tilla mund të ndikojnë aftësinë e Shoqërisë të marrë hua të reja, nëse është e nevojshme, dhe të



rifinancoje huat e ekzistuese me termat dhe rrethanat e ngjashme me ato te aplikuara ne transaksionet e mëhershme.

*iii. Impakti ne debitor dhe huamarrës*

Debitorët e Shoqërisë mund te ndikohen nga situata me likuiditet të ulet që mund te ule aftësinë e tyre për te paguar. Përkeqësimi i kushteve operative për debitorët mund te ndikojnë gjithashtu menaxhimin e parashikimit te mjeteve monetare dhe supozimet e zhvlerësimeve te aktiveve financiare dhe jo-financiare. Për sa kohe informacioni është i vlefshëm, menaxhimi ka reflektuar ne mënyrë te sakte parashikimet e mjeteve monetare te ardhme ne zhvlerësimet e tyre.

**o) Risku i kredisë**

Ne saje te limitit te volumit dhe llojshmërisë se bazës se klientëve te Shoqërisë, përqendrimet e riskut te kredisë ne lidhje me llogarite e arketueshme janë te limituara. Zhvlerësimi i llogarive të arketueshme mbahen në shumën e konsideruar te nevojshme për te mbuluar riskun potencial ne mbledhjen e tepricave te llogarive te arketueshme.

**p) Risku i likuiditetit**

Risku i likuiditetit eshte rrisku qe shoqeria mund te mos jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj lidhur me detyrimet financiare ne momentin e pageses. Risku i likuiditetit eshte rrisk i genesisshem ne biznesin e Shoqërisë per disa aktive specifike te blera apo detyrime te shituar mund te kene karakteristika likuiditeti qe jane specifike. Shoqëria menaxhon rriskun e likuiditetit duke monitoruar ne menyre te vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar te perputhe profilet e maturitetit te aktiveve dhe detyrimeve .

**q) Risku i tregut**

*i. Risku i normave te interesit*

Shoqëria përballet me riskun e normës së interesit të fluksit të parave në lidhje me overdrafte dhe hua qe Shoqëria mund te marr me norma variable. Manaxhimi nuk ka hyrë në ndonje derivative për të mbrojtur riskun.


*ii. Risku i kursit te këmbimit*

Shoqëria nuk përballet me riskun e kursit te këmbimit nga veprimet e saj normale. Sidoqoftë, ka gjendje te konsiderueshme Euro që i detyrohen klientët dhe vete Shoqëria kundrejt furnitorëve qe e ekspozojnë Shoqërinë ndaj riskut te normës se këmbimit. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për t'u mbrojtur nga ky risk.

**r) Analiza e ndjeshmërisë**

Me anë te administrimit të riskut të normave të interesit dhe të pozicionit valutor, Shoqëria synon të redukoje ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë, sidoqoftë, ndryshimet e përhershme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Më 31 Dhjetor 2010 është vlerësuar se një ndryshim në përqindjen e normave të interesit në vlerën e Lek-ut kundrejt valutave të tjera nuk do të ndikojë konsiderueshëm fitimin e Shoqërisë para tatimit mbi fitimin.

**s) Administrimi i kapitalit**



*h2*



EKSPERTI I KONTABEL TE REGJISTRUAR  
Fatbardha Shirepi,  
Neshat Mazaj

Politika e Shoqërisë është të mbaje një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Bordi i Drejtorëve monitoron kthimet nga kapitali, të cilat Shoqëria i përcakton si të ardhura neto të shfrytëzimit ndaj totalit të kapitalit, duke përjashtuar shlyerjen e aksioneve preferenciale dhe interesat e minoriteteve. Menaxhimi dhe grupi monitoron gjithashtu nivelin e dividendeve.

Shoqëria përpiqet të mbaje një balance ndërmjet të ardhurave me të larta që mund të jete e mundur me nivelet me të larta të huave dhe avantazheve dhe letrave me vlerë të dhëna nga një pozicion i mirë kapital.

Nuk ka ndryshime në përjashtjen e Shoqërisë për menaxhimin e kapitalit gjatë vitit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente rregullatore.

#### t) Kontabiliteti mbrojtës dhe instrumentet derivative financiare

Shoqëria nuk përdor instrumenta financiare mbrojtëse, pavarësisht se është e ekspozuar ndaj riskut financiar.

### 3) ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin nr 9228 date 29 04 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar me ligjin nr 9477 date 09.02.2006, Shoqëria ka ndërtuar një plan të llogarive vetjake në përputhje e në zbatim të SKK të Permiresuara të publikuara nga KKK. Standardet janë zbatuar deri në nivelin e që ato janë përkthyer dhe adoptuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Shqipëri (KKK). Departamenti i Kontabilitetit perbehet nga një person specialiste finance.

#### 4) SHPJEGIME TE PASQYRAVE FINANCIARE TE SHOQERISE TE VITIT 2015

##### PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR AKTIVET

Zeri A-A,1 Mjete Monetare në fund të vitit kanë vlerën 68,443 leke, të ndara në Mjete Monetare në Banke dhe Mjete Monetare në Arke, të ndara sipas monedhave dhe të konvertuara me kursin zyrtar të Bankes së Shqipërisë sipas tabelës me poshte:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
A-A,1	MJETET MONETARE	68,443.00	3,352,456.00
A.A.1.1	Banka	66,954.00	3,337,427.00
i	Vlera monatare në leke	66,954.00	3,337,427.00
ii	Vlera monatare në Euro		
iii	Vlera monatare në USD		
A.A.1.2	Arka	1,489.00	15,029.00
i	Vlera monatare në leke	1,489.00	15,029.00
ii	Vlera monatare në Euro		
iii	Vlera monatare në USD		



Handwritten signature or initials.



EKSPERTIZË DHE KONTABILITETI TABEL TE REGJISTRUAR  
Fatbardha Shitca,  
Neshat Mazaj

Zëri A-A,3 Te drejta te Arketueshme në fund të vitit kane vlerën 1,193,862,919 leke, qe perfaqesojne kerkesa te arketueshme nga pale te lidhura,e debitorete tjere te ndara sipas tabelës se meposhtme ne zerat perkates:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
A-A,3	TE DREJTA TE ARKETUESHME	1,193,862,919.00	1,193,605,816.00
A-A,3 1	Nga aktiviteti i shfrytezimit	181,990,903.00	181,990,903.00
A-A,3 2	Nga njesite ekonomike brenda Grupit	7,242,496.00	6,988,393.00
A-A,3 3	Nga njesite ekonomike me plesemarrje	-	-
A-A,3 4	Kerkesa te tjera te arketueshme	1,004,629,520.00	1,004,626,520.00
A-A,3 5	Kapitali I Nenshkrusur i Papaquar	-	-

Zëri A-A,3,1 Kerkesa te Arketueshme (Kliente) në fund të vitit kane vlerën 181,990,903 leke, te ndara ne menyre analitike. Klientet ne valute jane konvertuar ne leke me kursin kursin zyrtar te Bankes se Shqiperise dhe paraqitn sipas tabelës se meposhtme:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
A-A,3	TE DREJTA TE ARKETUESHME	181,990,903.00	181,990,903.00
A-A,3 1	Nga aktiviteti i Shfrytezimit (Kliente)	181,990,903.00	181,990,903.00
1	Korporata e Bakrit Tirane	145,078,936.00	145,078,936.00
2	Kliente per shitje e sherbime	36,713,967.00	36,713,967.00
3	Brahim Sinani	198,000.00	198,000.00

Zëri A-A,3,2 Nga njesite ekonomike brenda grupit në fund të vitit kane vlerën 7,242,496 leke, te ndara ne menyre analitike sipas tabelës se meposhtme:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
A-A,3	TE DREJTA TE ARKETUESHME	7,242,496.00	6,988,393.00
A-A.3.4	Te tjera Kerkesa te Arketueshme		
i	Debitorë	7,039,145.00	6,942,635.00
1	Tren Xhabija	1,386,600.00	1,386,600.00
2	Elvis Pjalmi	1,260,400.00	1,260,400.00
3	Myfit Lezha	4,081,825.00	4,081,825.00
4	Dritan Kraja	79,860.00	79,860.00
5	Firma Nika	230,460.00	133,950.00
ii	TVSH	203,351.00	45,758.00



*Handwritten signature*





EKSPERTIZA KONTABEL TE REGJISTRUAR  
Fatbardha Shatri,  
Neshat Mazaj

**TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTERA 1,193,931,362 leke**

Zeri A-B,2 Aktivitet Afatgjata Materiale per 286,009 leke perfaqeson vleren neto te A.A.M-ve, nga vlera e blerjes eshte zbritur amortizimi deri ne fund te vitit. AAM-te paraqiten te grupuara sipas tabelës se meposhtme

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
<b>A.B</b>	<b>AKTIVE AFATGJATA MATERIALE NETO</b>	<b>286,009.00</b>	<b>289,652.00</b>
A.B.2.1	Toka Troje Terene	-	-
A.B.2.2	Ndertesa Ndertime ne Proces	-	-
A.B.2.3	Makineri e Pajisje	-	-
i	Makineri	-	-
ii	Pajisje Kompjuterike	10,931.00	14,574.00
iii	Te tjera Instalime e Pajisje	275,078.00	275,078.00
A.B.2.4	Te tjera Aktive Afatgjata Materiale	-	-
i	Pajisje Zyre	-	-
ii	Mjete transporti	-	-
iii	Pajisje Informatike	-	-
A.B.2.5	Parapagime per aktive AAGJ ne Proces	-	-

**TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA 286,009 leke**

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR AKTIVET TOTALI 1,194,217,371 leke**

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR DETYRIMET DHE KAPITALI**

Zeri D-A-1 (3) Detyrimet Afatshkurtera per 6,769,765 leke perfaqesojne detyrimet ndaj shoqerise gjendje ne mbyllje te vitit ushtrimor te cilat mbahen dhe analizohen ne menyre analitike nga shoqeria sipas tabelës se meposhtme

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
<b>D.A,1</b>	<b>DETYRIME AFATSHKURTERA</b>	<b>6,769,765.00</b>	<b>7,487,763.00</b>
1	Titujt e huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj institucioneve te kredise	-	-
3	Arketime ne avance per porosi	-	-
4	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	3,619,146.00	3,440,842.00
5	Deftesa te pagueshme	-	-
6	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit	-	-
7	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike me pjesmarrje	-	-
8	Te pagueshme Sigurimet dhe Punonjesit	1,113,979.00	2,137,998.00
9	Te pagueshme per detyrimet tatimore	147,120.00	19,403.00
10	Te tjera	1,889,520.00	1,889,520.00



*Handwritten signature*

Zeri D-A-1 *Te Pagueshme per Aktivitetin e Shfrytezimit* perfaqeson detyrimet e shoqerise ndaj te treteve ,detyrime keto qe do te likujdohen brenda vitit ushtrimor pasardhes per 3,619,146 leke.Zeri D-A,3 Te ardhura te shtyra eshte 1,000,000 leke per qe perfaqeson te ardhurat ne vitin pasardhes. Zeri D-A,4 Provizione eshte me vlere 614,010 leke .

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
<b>D.A.1</b>	<b>DETYRIME AFATSHKURTERA</b>	<b>6,769,765.00</b>	<b>7,487,763.00</b>
<b>D.A.3</b>	<b>Arketime ne Avance per Porosi</b>	-	-
3(i)	Parapagime te marra		
<b>D.A.4</b>	<b>Te Pagueshme ndaj Furnitoreve</b>	<b>3,619,146.00</b>	<b>3,440,842.00</b>
4(i)	Furnitore per mallra e sherbime	3,619,146.00	3,440,842.00
4(ii)	Furnitore per aktive afatgjate		
<b>D.A.8</b>	<b>Te Pagueshme ndaj Punonjesve</b>	<b>1,113,979.00</b>	<b>2,137,998.00</b>
8(i)	Paga dhe shperblime	1,113,979.00	2,137,998.00
<b>D.A.9</b>	<b>Detyrime Tatimore</b>	<b>147,120.00</b>	<b>19,403.00</b>
9(i)	Tatim mbi te ardhurat personale	19,500.00	2,600.00
9(ii)	Sigurime Shoqerore	92,070.00	16,803.00
9(iii)	Tatim te tjera e Tatim ne burim	35,550.00	-
<b>D.A.10</b>	<b>Te Pagueshme te tjera</b>	<b>1,889,520.00</b>	<b>1,889,520.00</b>
10(i)	Derdhjen ne buxhet per te ardhura nga qerate	1,304,100.00	1,304,100.00
10(ii)	Nevojat e U.E.M per sigurime	585,420.00	585,420.00

Zeri D-A-3 *Te Pagueshme per Aktivitetin e Shfrytezimit* perfaqeson detyrimet e shoqerise ndaj furnitorëve per 3,619,146\_ leke. Detyrimet ndaj furnitoreve jane detyrime ne mbyllje te vitit ushtrimor dhe jane ne leke dhe ne valute. Detyrimet ne valute jane konvertuar ne monedhen baze me kursin zyrtar te Bankes se Shqiperise ne mbyllje te vitit. Analitikisht furnitoret paraqiten ne tabelen e meposhtme:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
<b>D.A.4</b>	<b>TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE</b>	<b>3,619,146.00</b>	<b>3,440,842.00</b>
<b>D.A.4,(i)</b>	<b>Furnitore per mallra e sherbime</b>	<b>3,619,146.00</b>	<b>3,440,842.00</b>
1	Eksperti I makinerive	15,000.00	-
2	Eksperti kontabel	513,000.00	550,000.00
3	Sherbimi postar	730.00	1,650.00
4	Keshilli mbikqyres	335,748.00	134,524.00
5	"Alpetrol" sh.a Patos	2,754,668.00	2,754,668.00

Zeri D-B-1 *Detyrimet Afatgjata* perfaqeson detyrimet e shoqerise ndaj te treteve per \_40,907,113\_ leke. Detyrimet Afatgjata jane detyrime qe do te shlyhen per periudha me te gjata se nje vit.



*Handwritten signature or initials.*



EKSPERTE KONTABEL TE REGJISTRUAR  
Fatbardha Shtrapi,  
Neshat Mazaj

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
D.B.1	DETYRIMET AFATSHKURTERA	40,907,113.00	40,907,113.00
D.B.1	Tituj te Huamarjes	-	-
D.B.2	Detyrime ndaj institucioneve te kredise		
D.B.3	Arketimet ne avance per porosi		
D.B.4	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit Hua ( A. P Durri	10,000,000.00	10,000,000.00
D.B.5	Deftesa te pagueshme	-	-
D.B.6	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit	-	-
D.B.7	Te pagueshme ndaj njesive ekonomike me pjesemarrje	-	-
D.B.8	Te tjera te Pagueshme (Financime Ortaku)	30,907,113.00	30,907,113.00

**TOTALI I DETYRIMEVE 203,645,005 leke**

#### **KAPITALI**

Zeri K-A. 1. *Kapitali Aksionar* në vlerën 0 leke shoqëria nuk ka kapital te nenshkruar mbasi eshte dege e shoqërisë me me . Zeri K-A. 4, ii *Rezerva Ligjore* per zero leke, perfaqeson rezervat ligjore te krijuara gjate veprimtarise ekonomike deri ne mbyllje te vitit. Zeri K-A. 5, *Fitimi (Humbja) e pashperndare* perfaqeson humbjen e mbartur te shoqërisë në vlerën 0 lekë e krijuar ne vitet paraardhese. Zeri K-A. 5, *Fitimi (Humbja) i vitit financiar* perfaqeson rezultatin e shoqërisë në vlerën 0 lekë e krijuar ne vitin ushtrimor sipas tabelës se meposhtme:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
K.A.	KAPITALI	990,572,366.00	992,887,921.00
K-A.1	Kapitali aksionar	938,200,000.00	938,200,000.00
K-A.2	Primi i lidhur me kapitalin	102,743,993.00	102,743,993.00
K-A.3	Rezerva rivleresimi	650,516.00	650,516.00
K-A.4	Rezerva te tjera	5,690,279.00	5,690,279.00
ii	Rezerva ligjore	433,490.00	433,490.00
iii	Rezerva te tjera	5,256,789.00	5,256,789.00
K-A.5	Fitimi i pashperndare	(54,396,867.00)	(54,135,572.00)
K-A.6	Fitimi (humbje) e vitit financiar	(2,315,555.00)	(261,295.00)

**TOTALI I KAPITALIT 990,572,366 Leke**

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR DETYRIMET DHE KAPITALI TOTALI 1,194,217,371 leke**

#### **PASQYRA E PERFORMANCES TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET**

**ZERI 1 TE ARDHURAT**, fillon me: Zëri P.P. *Te Ardhurat* të cilat për vitin ushtrimor janë 96,510 lekë dhe ndahen sipas tabelës:



*Jar*



EKSPERTELE KONTABEL TE REGJISTRUAR  
Fatbardha Shtrepi,  
Neshat Mazaj

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
P.P	TE ARDHURA	96,510.00	2,121,625.00
P.P.1	Te Ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit	96,510.00	2,121,625.00
P.P.2	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimt në proces	-	-
P.P.3	Puna e Kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	-	-
P.P.4	Te ardhura te tjera te shfrytezimit	-	-

**ZERI 2 SHPENZIMET** Zëri P.P. Shpenzime te cilat per vitin ushtrimor jane 2,400,465 leke dhe klasifikohen ne menyre te permbledhur sipas tabelës se meposhtme:

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
P.P	SHPENZIME	(2,400,465.00)	(2,389,081.00)
P.P.5	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	-	-
1	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	-	-
2	Mallra	-	-
3	Te tjera shpenzime	-	-
P-P.6	Shpenzime te personelit	(1,091,670.00)	(1,820,490.00)
1	Pagat & Shperblimet	(935,450.00)	(1,559,977.00)
2	-shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	(156,220.00)	(260,513.00)
3	-shpenzime per honorare	-	-
P-P.7	Zhvleresimi i AAGJ	-	-
P-P.8	Shpenzime Konsumi & Amortizimi	(3,643.00)	(4,857.00)
P-P.9	Shpenzime të tjera shfrytezimi	(1,305,152.00)	(563,734.00)

Zëri P.P.6. Shpenzime te Personelit në vlerën prej 1,091,670 leke, nga te cilat për pagat e punonjësve 935,450 leke, për sigurimet shoqërore 156,220 leke që paguan njësia në emër të punonjësve .

Reff.	PERSHKRIMI	VITI USHTRIMOR	
		31 DHJETOR 2015	31 DHJETOR 2014
P.P	SHPENZIME	(1,091,670.00)	(1,820,490.00)
P-P.6	Shpenzime te personelit	-	-
1	Pagat & Shperblimet	(935,450.00)	(1,559,977.00)
2	-shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	(156,220.00)	(260,513.00)
3	-shpenzime per honorare	-	-

